REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE DURRËS

NOTER VIOLA PETANI
ADRESA lagja nr. 3, sheshi " Liria ", qendra e biznesit "Best Co ", kati V
TEL: 0694053520

# KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(AKSIONE)

**Nr. repertori: 1073** **Nr. koleksioni: 640**

**Durres më 02/06/2023**

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

A202301396007201I000

*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë

A20230139600072011000

**TË SHITJE E PASURISË SË LUAJTSHME E LLOJIT KUOTË KAPITALI**

"CONFEZIONI ROGER" sh.p.k

Në Durrës, sot në datën 02/Qershor/2023 (dymijë e njëzetë e tre), para meje Noteres Viola I. Petani në Zyrën Noteriale me seli në Durres, në lagja nr. 3, sheshi "Liria", Qendra e Biznesit "Best Co", kati i 5-të, u paraqitën personalisht palët:

**Në cilësinë e palës shitëse:**

1. **Znj. Blerta Aliu**, atësia Bujar, amësia Myzejen, shtetase shqiptare, lindur në Durrës dhe banuese në Durrës, me adresë: Dëshmorëve 00690173, Nd. 8, H. 1, 2003, lindur më 27/08/1985, gjendja civile e martuar, madhore, me zotësi juridike dhe zotësi të plotë dhe për të vepruar, për identitetin e së cilës u garantova nga karta e identitetit me nr. personal I55827067E, **ortak me 1 pjesë, me 51% pjesëmarrje në kapitalin themeltar.**
2. **Z. Leonardo Dicuonzo,** atësia Ruggiero, amësia Digaeta Anna, shtetase italian, lindur në Barletta (BA), me vendqendrim në Itali, via Fermi E., N, 1 D Barletta (BT), lindur më 18/04/1974, gjendja civile i martuar, madhor, me zotësi juridike dhe zotësi të plotë dhe për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova nga karta e identitetit nr. CA08623LL, lëshuar nga Republika e Italisë në datën 11/03/2022, e vlefshme deri në datën 18/04/2032, kodi fiskal DCNLRD74D18A669L, **ortak me 1 pjesë, me 49 % pjesëmarrje në kapitalin themeltar.**

**Z. Leonardo Dicuonzo deklaron se nuk e njeh gjuhën shqipe** dhe bazuar në nenin 100 të Ligjit për noterinë "Kur i interesuari, njëra ose të dyja palët, nuk dinë gjuhën shqipe, noteri, kryesisht, nëse pranohet prej palëve, ose nëpërmjet një përkthyesi që pranohet prej tij dhe palëve, përkthen të gjithë përmbajtjen e aktit, ku shënohet edhe deklarimi i palës ose palëve se e kanë kuptuar dhe pranuar përmbajtjen e tij" **kërkon dhe pranon që ky akt të përkthehet nga përkthyesja e liçencuar nga Ministria e Drejtësisë për gjuhën italiane znj. Rudina Taraneshi, e njohur personalisht nga unë noterja.**

**Në cilësinë e palës blerëse:**

1. **Z. Gabriele Albanese,** atësia Ruggiero, amësia Seregola Angela, shtetase italian, lindur në Barletta (BA), me vendbanim në Itali, në adresën: via Mariano Santo, N. 47 Barletta (BT), lindur më 13/04/1971, gjendja civile gjendja civile i martuar, madhor, me zotësi juridike dhe zotësi të plotë dhe për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova nga karta e identitetit nr. CA43128MO, lëshuar nga Republika e Italisë në datën 28/07/2022, e vlefshme deri në datën 13/04/2033, kodi fiskal LBNGRL71D13A669V.

**Z. Gabriele Albanese deklaron se nuk e njeh gjuhën shqipe** dhe bazuar në nenin 100 të Ligjit për noterinë "Kur i interesuari, njëra ose të dyja palët, nuk dinë gjuhën shqipe, noteri, kryesisht, nëse pranohet prej palëve, ose nëpërmjet një përkthyesi që pranohet prej tij dhe palëve, përkthen të gjithë përmbajtjen e aktit, ku shënohet edhe deklarimi i palës ose palëve se e kanë kuptuar dhe pranuar përmbajtjen e tij" **kërkon dhe pranon që ky akt të përkthehet nga përkthyesja e liçencuar nga Ministria e Drejtësisë për gjuhën italiane znj. Rudina Taraneshi, e njohur personalisht nga unë noterja.**

**Baza Ligjore:**

1. Neni 149, 705 e vijues të Kodit Civil,
2. Neni 73 e vijues të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
3. Ligji nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".

A2023013960072011000

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, unë noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja redaktimin e kontratës së shitjes së pasurisë së luajtshme të llojit kuotë në "Confezioni Roger" sh.p.k, sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

**Hyrje**

"Confezioni Roger" sh.p.k, me seli Durrës, me adresë: Durres, Lagjja nr. 15, rruga Shënavlash, objekti me nr. pasurie 5/276, zona kadastrale 8511, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesve në datën 28/03/2022, pajisur me NUIS M21528508M, ushtron aktivitet tregtar me objekt "*Prodhim veshmbathje konfeksione me material porosites, prerje, qepje, stampime, tregtimi i tyre brenda dhe jashte vendit. Tregti import-ekport artikuj te ndryshem me material te prere, lendes se pare per veprimtarine fason. Import□eksport te artikujve te ndryshem industrial dhe te tjere, transport per vete dhe te trete*".

**Kapitali Themeltari** shoqërise është i përbërë nga 2 kuota, me kapital të përgjithshëm 100'000 (njëqind mijë) lekë, kapital i cili zotërohet nga dy ortakët znj. Blerta Aliu me 51% pjesëmarrje dhe z. Leonardo Dicuonzo me 49 % pjesëmarrje në kapitalin themeltar.

Bazuar në ekstraktin historik të "Confezioni Roger" sh.p.k të gjeneruar nga faqja zyrtare e Qendrës Kombëtare të Biznesit shoqëria është e lirë nga bllokimet, nga sekuestrot, nga kufizime të personave të tretë apo institucioneve të tjera shtetërore ose private mbi të.

Siç figuron nga formulari lëshuar nga Regjistri i Barrëve Siguruese sot në datën e nënshkrimit të kontratës, kuotat dhe shoqëria janë të lira nga barrat siguruese.

**Objekti dhe mënyra e pagimit të çmimit**

Objekt i kësaj kontrate është shitja e një pjese të kuotës së zotëruar nga ortaku i shoqërisë **znj. Blerta Aliu që përbën 17 % pjesëmarrje** në kapitalin themeltar të "Confezioni Roger" sh.p.k **dhe e** një pjese të kuotës së zotëruar nga ortaku i shoqërisë **z. Leonardo Dicuonzo që përbën 16 % pjesëmarrje** në kapitalin themeltar të "Confezioni Roger" sh.p.k **tek blerësi jashtë ortakërisë z. Gabriele Albanese per çmimin e përgjithshëm 33'000 (tridhjete e tre mijë) lekë,** nga të cilat 16'500 (gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind) lekë janë likujduar tek znj. Blerta Aliu dhe 16'500 (gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind) lekë janë likujduar tek z. Leonardo Dicuonzo.

**Detyrime të palëve**

Me lidhjen e kësaj kontrate znj. Blerta Aliu bëhet ortake me 1 kuotë me 34 % pjesëmarrje në kapitalin themeltar, z. Leonardo Dicuonzo bëhet ortak me 1 kuotë me 33 % pjesëmarrje në kapitalin themeltar dhe z. Gabriele Albanese bëhet ortak me 1 kuotë me 33 % pjesëmarrje në kapitalin themeltar.

Pala blerëse deklaron se qëllimi i hyrjes së tij në shoqëri është për të shtuar volumin e punës edhe nga qyteti Barletta Itali.

**Anekset e kontratës**

Kësaj kontrate i bashkëlidhen si pjesë përbërëse dhe të pandarë këto dokumente që do të quhen anekse të kontratës:

1. Vendimi i Asamblesë së Ortakëve
2. Informacioni i marrë nga Regjistri i Barrëve Siguruese.
3. Dokumentet e identifikimit të palëve kontraktuese.

A2023013960072011000

## Dispozitat përfundimtare

Kontrata e shitjes të kuotave të kapitalit u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të palëve kontraktuese, të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.

Kontrata hartohet në katër njësi, nga të cilat njëra depozitohet për ruajtje në arkivën e zyrës sime noteriale, një njësi depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit për regjistrim, një njësi për palën shitëse, dhe një njësi për palën blerëse.

Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”, vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10/03/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**PALA SHITËSE**

Blerta Aliu _______________ _______________

**PALA BLERËSE**

Albamere Nikieli _______________

**PËRKTHEU**

Rudina Taronesi _______________

**NOTERE**

**VIOLA I. PETANI (KONA)**

# EKSTRAKT HISTORIK I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

## GJENDJA E REGJISTRIMIT

| | | |
|---|---|---|
| 1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS) | M21528508M | |
| 2. Data e Regjistrimit | 28/03/2022 | |
| 3. Emri i Subjektit | CONFEZIONI ROGER | |
| 4. Forma ligjore | SHPK | |
| 5. Data e themelimit | 23/03/2022 | |
| 6. Kohëzgjatja | Nga: 23/03/2022 | |
| 7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri | Durres Durres DURRES Lagjja nr.15, Rruga Shenavlash, objekti me nr.pasurie 5/276, dhe zone kadastrale 8511 | |
| 8. Kapitali | 100.000,00 | |
| 8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave | 2,00 | |
| 9. Objekti i aktivitetit | Prodhim veshmbathje konfeksione me material porosites, prerje, qepje, stampime, tregtimi i tyre brenda dhe jashte vendit. Tregti import-eksport artikuj te ndryshem me material te prere, lendes se pare per veprimtarine fason. Import-eksport te artikujve te ndryshem industrial dhe te tjere, transport per vete dhe te trete. | |
| 10. Administratori/ët | Blerta Aliu | |
| 10.1 Afati i emërimit | Nga: 23/03/2022 | Deri: 23/03/2027 |
| 11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore | | |
| 11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka) | | |
| 12. Ortakët | BlertaAliu | |
| 12.1 Vlera e kapitalit | Para: 51.000,00 | Natyre: |
| 12.2 Numri i pjesëve | 1,00 | |
| 12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 51,00 | |
| *- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)* | | |
| 13. Ortakët | LEONARDODICUONZO | |
| 13.1 Vlera e kapitalit | Para: 49.000,00 | Natyre: |
| 13.2 Numri i pjesëve | 1,00 | |
| 13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 49,00 | |
| *- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)* | | |
| 14. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit | | |
| 15. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht | Emri Tregtar: CONFEZIONI ROGER<br>E-Mail: confezioniroger@icloud.com<br>shazivari.blerta@yahoo.com<br>Telefon: 0692984026 | |
| 16. Statusi: | Aktiv | |



Lista e Dokumenteve:
Akti i themelimit
Statuti (nese eshte hartuar si dokument i ndryshem nga akti i themelimit)

Regjistrimi Fillestar: CN-882172-03-22

## HISTORIKU I REGJISTRIMIT

| Data e regjistrimit | Ndryshimi i te dhenave te regjistruara |
|---|---|

Datë: 02/06/2023

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

Blerta Aliu
Digitally signed by Blerta Aliu
Date: 2023.06.14 15:30:07 +02'00'

Kopje nga web